



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Analizë mbi përdorimin e “Kos Giro”

Q e r s h o r 2 0 1 6

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Analizë mbi përdorimin e “Kos Giro”**

**BOTUES** ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Sistemit të Pagesave  
33 Garibaldi, Prishtinë 10000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 244 410

**FAQJA E INTERNETIT** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**ADRESA ELEKTRONIKE** [payment.systems@bqk-kos.org](mailto:payment.systems@bqk-kos.org)

Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj, Drejtore e Departamentit të Sistemit të Pagesave  
Masar Baxhaku, Analist për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave  
Qëndresa Krasniqi, Zyrtare për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave

## HYRJE

Ekonomia moderne nuk do të ishte efikase pa funksionim të sistemit të pagesave, përfshirë shërbime të pagesave të sigurta, inovative dhe të qëndrueshme që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e konkurrencës në treg.

Objektiv i kësaj analize janë zhvillimet në kuadër të skemës së pagesave “Kos Giro”, duke përfshirë si pagesat e realizuara përmes kësaj skeme, ashtu edhe ato të realizuara brenda bankës të cilat nuk kalojnë përmes skemës “Kos Giro” (kur debitori dhe kreditori janë klient të së njëjtës bankë) por që i përmbajnë tiparet e saj.

Në këtë dokument janë analizuar më hollësisht zhvillimet e kësaj skeme të pagesave, duke u përpjekur që në mënyrë sa më të saktë të analizohet zhvillimi i saj ndër vite, duke pasqyruar sfidat dhe njëkohësisht faktorët që kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të saj, e cila tanimë është pjesë shumë e rëndësishme e Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), duke përbërë njërën nga skemat më të mëdha të këtij sistemi, i cili vazhdon të operojë me një siguri dhe besueshmëri të lartë për përdoruesit e tij.

Departamenti i Sistemit të Pagesave edhe në të ardhmen synon që në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike, bankat komerciale, kompanitë e shërbimeve publike dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë skemë, të vazhdojë zhvillimin e saj duke synuar kryesisht rritjen e pagesave përmes formave elektronike apo llogarive bankare, me qëllim të zvogëlimit të pagesave me para të gatshme për arsye të sigurisë dhe efikasitetit.


## Skema Kos Giro

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) operon dhe zotëron sistemin e vetëm të pagesave ndërbankare në Kosovë të njohur si Sistem Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN). SEKN-ja është sistem i integruar i pagesave në të cilin janë të përfshirë disa skema, si për pagesat me vlera të mëdha, ashtu edhe për ato me vlera më të vogla.

Në objektivat e Departamentit të Sistemit të Pagesave (DSP) është ofrimi i një sistemi të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave, njëkohësisht duke synuar edhe zhvillimin e formave të reja të pagesave, me vëmendje të veçantë në pagesa elektronike. Ndër shumë zhvillime që e kanë përcjellë SEKN-në në vite është edhe krijimi i skemës së pagesave Kos Giro, e cila u mundëson klientëve kryerjen e pagesave për disa shërbime të caktuara, me një faturë të standardizuar.

Pjesëmarrës në skemën Kos Giro janë të gjitha institucionet e pagesave të licencuara nga BQK-ja, si dhe të gjitha kompanitë dhe institucionet faturuese, pagesat për shërbimet e të cilave kryhen përmes kësaj skeme. Po ashtu për pjesëmarrje në skemën Kos Giro, institucionet duhet të jenë pjesëmarrëse edhe në SEKN.

**Figura 1.** Funksionimi i Skemës Kos-Giro



Në figurën 1 është paraqitur mënyra e funksionimit të skemës së pagesave Kos Giro. Lëshuesi i faturës (kompanitë publike apo pjesëmarrësit e tjerë në skemë), faturën Kos Giro ua dorëzojnë klientëve të cilët pastaj kryejnë urdhërtransferin në cilëndo bankë komerciale (përmes llogarive apo me para të gatshme) apo edhe në institucionet financiare jobankare të licencuara nga BQK-ja. Përmes sistemit të SEKN-së bankat komerciale i dërgojnë urdhërtransferet e grumbulluara në bankën ku faturuesi mbanë llogarinë bankare, e pastaj kjo e fundit i bart mjetet në këtë llogari të faturuesit. I gjithë procesi është i automatizuar dhe kryhet në mënyrë shumë efikase.

## Fatura Kos Giro

Fatura Kos Giro është projektuar që të përdoret nga faturuesit, paguesit dhe institucionet financiare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar procesimit automatik në shkallë të lartë, veçanërisht nga institucionet financiare. Procesimi automatik i shkallës së lartë i vendos të dhënat e caktuara në formular, sidomos në pjesën që dorëzohet.

Fatura Kos Giro është dokument i standardizuar i përbërë nga dy pjesë: pjesa për pagesë dhe kuponi që i kthehet konsumatorit. Këto fatura përmbajnë të dhëna mbi pagesën në “barcode” të tyre. Ky “barcode” lexohet nga “barcode” lexuesit të sportelet e bankave dhe pagesa procesohet automatikisht nga ana e bankës.

**Figura 2.** Fatura Kos Giro (versioni 1.3)

The image shows a form for a Kos-giro payment. The form is divided into several sections:

- Top Left:** A logo with the letter 'K' and instructions: "Ju lutem shkëputeni këtë pjesë / Molimo vas pocepate ovaj deo / Please retain this stub".
- Top Center:** The title "Kos-giro" and a small 'T' in the top right corner.
- Amount Section:** "Shuma / Iznos / Amount" with a Euro symbol (€) and a field for the amount, followed by "Euro" and "Ct" (cent) fields.
- Bank Account Section:** "Prej llogarisë së bankës / Od ziro racuna / From bank account" with a barcode-like field.
- Sender Information:** "Prej / Od / From", "Emri / Ime / Name", "Adresa / Adresa / Address", and "Vendi / Mesto / Place".
- Recipient Information:** "Për / Za / To" with a field for the recipient's name.
- Signature Section:** "Nënshkrimi / Potpis / Signature" with a line for a signature.
- Bottom Section:** "Ju lutem mos shkruani në hapësirën më poshtë / Ne pisi u donju povrsinu / Please do not write in this space below please do not fold". It includes checkboxes for "Referenca / Referencia / Reference", "Prej / Od / From", "Euro", "Ct", "Për / Za / To", and a "code" field.
- Bottom Left:** A small box with instructions: "Ju lutem shikoni mbrapa për udhëzime / Molimo vas pogledate pozadi za uputstva / See reversed side for instructions".
- Bottom Right:** A logo with the letter 'K' and the text "© BPK".

Pos versionit 1.3 të faturës Kos Giro, me kërkesë të kompanive pjesëmarrëse në skemë janë dizajnuar edhe tri versione të tjera: versioni 1.4 1.5 dhe 1.6<sup>1</sup>.

## Zhvillimi i Skemës Kos Giro

Funksionimi i sigurt dhe efikas i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) ka rezultuar me rritje të numrit dhe vlerës së transaksioneve të procesuara përmes këtij sistemi. Njëkohësisht edhe numri dhe vlera e pagesave të skemës Kos Giro kanë shënuar rritje, bashkë me rritjen e kompanive që përdorin këtë skemë.

**Tabela 1.** Numri dhe vlera e transaksioneve Kos Giro ndërbankare

	Numri	Vlera (euro)
<b>2009</b>	377,460	671,649,728.54
<b>2010</b>	419,329	734,367,963.86
<b>2011</b>	496,197	871,170,119.17
<b>2012</b>	543,338	892,130,912.76
<b>2013</b>	692,281	899,986,956.00
<b>2014</b>	1,013,620	949,316,256.00
<b>2015</b>	1,349,316	1,048,213,712.00


Burimi: BQK (2016)

Në tabelën 1 është paraqitur numri dhe vlera e transaksioneve ndërbankare të realizuara përmes skemës Kos Giro nga viti 2009 deri në vitin 2015. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të konstatohet për rritjen e vazhdueshme si të numrit, ashtu edhe të vlerës së transaksioneve të skemës Kos Giro.

Rritja e numrit të transaksioneve Kos Giro gjatë viteve ishte si vijon: në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009 numri i transaksioneve u rrit rreth 11 për qind, në vitin 2011 numri i transaksioneve u rrit 18.3 për qind, në vitin 2012 rritja ishte 9.5 për qind, në vitin 2013 27.4 për qind, në vitin 2014 46.4 për qind, ndërsa në vitin 2015 numri i pagesave Kos Giro u rrit për 33.1 për qind.


Në grafikun në vijim më së miri mund të shihet lëvizja e numrit të transaksioneve të skemës Kos Giro ndër vite.

<sup>1</sup> Versionet e faturës Kos Giro janë të publikuara në faqen zyrtare të BQK-së [http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza\\_ligjore/shqip/Udhezim%20per%20operim%20te%20skemes%20se%20pagesave%20kos%20GIRO.pdf](http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Udhezim%20per%20operim%20te%20skemes%20se%20pagesave%20kos%20GIRO.pdf)

**Figura 3.** Numri i transaksioneve Kos Giro ndërbankare

Burimi: BQK (2016)

Krahas rritjes së numrit të transaksioneve Kos Giro, po ashtu edhe vlera e tyre është rritur nga viti në vit. Vlera e transaksioneve Kos Giro gjatë vitit 2010 u rrit 9.3 për qind, në vitin 2011 18.6 për qind, në vitin 2012 2.4 për qind, në vitin 2013 0.88 për qind, në vitin 2014 5.5 për qind, ndërsa rritja e vlerës së pagesave përmes skemës Kos Giro në vitin 2015 ishte 10.4 për qind. Në grafikun në vijim më së miri mund të shihet rritja e vlerës së transaksioneve të skemës Kos Giro ndër vite.

**Figura 4.** Vlera e transaksioneve Kos Giro ndërbankare

Burimi: BQK (2016)

Në tabelën 2 janë paraqitur të dhënat për numrin dhe vlerën e pagesave Kos Giro brenda bankës sipas raporteve të bankave komerciale të raportuara në BQK, bazuar në metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave. Nga të dhënat e raportuara, shihet se gjatë vitit 2011 numri i transaksioneve Kos Giro brenda bankës pati rritje prej rreth 25.9%, ndërsa trendi i rritjes së vlerës të këtyre transaksioneve ishte rreth 183%. Në vitin 2012, numri i transaksioneve Kos Giro brenda bankës pati rënie prej rreth 7.9%, ndërsa vlera e tyre shënoi rritje të lehtë prej rreth 1.9%. Në vitin 2013 numri i pagesave Kos Giro brenda bankës u rrit për 0.65 për qind, ndërsa vlera u rrit për 7.1 për qind. Ndërsa në vitin 2014 dhe 2015 si numri, ashtu edhe vlera e pagesave Kos Giro brenda bankës ka



shënuar rënie të konsiderueshme, pasi që janë rritur transaksionet Kos Giro ndërbankare.

**Tabela 2.** Numri dhe vlera e transaksioneve Kos Giro brenda bankës


Vitet	Numri	Vlera
2010	151,522	101,791,642.34
2011	190,794	288,675,984.93
2012	175,746	294,146,975.00
2013	176,880	314,920,822.65
2014	135,082	194,183,806.58
2015	54,796	10,242,810.05

Burimi: Bankat komerciale

## Pjesëmarrja e pagesave Kos Giro në SEKN


Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) është sistem i integruar për pagesa, i cili në vete përfshin disa skema të pagesave dhe njëra ndër të është skema e pagesave Kos Giro. Me kalimin e viteve kjo skemë ka rritur pjesëmarrjen e saj në kuadër të SEKN-së dhe tani paraqet njërin nga pjesëmarrësit më të rëndësishëm të sistemit të pagesave. Në figurat në vazhdim është paraqitur pjesëmarrja e numrit, si dhe vlerës së pagesave Kos Giro në SEKN për vitin 2015. Sa i përket numrit, pagesat Kos Giro janë të tretat me 13.72 % (pas atyre të rregullta masive dhe të rregullta individuale), ndërsa sa i përket vlerës, ato janë pjesëmarrësi i dytë më i madh me 14.03 % (pas pagesave të rregullta).

Figura 5. Pjesëmarrja e transaksioneve (numër)



Burimi: BQK

Figura 6. Pjesëmarrja e transaksioneve (vlerë)



Burimi: BQK

## Njoftimi i klientëve me skemën Kos Giro

Kompanitë faturuese pjesëmarrëse në skemën Kos Giro duhet t'u sqarojnë klientëve përfitimet nga kjo skemë, veçanërisht kushtet e volitshme të saj lidhur me shpejtësinë dhe saktësinë gjatë procesimit.

Klientët e kompanive mund të shfrytëzojnë pothuajse të gjitha sportelet e çdo institucioni të autorizuar nga BQK-ja për kryerje të shërbimeve të pagesave në Kosovë.

Kos Giro u mundëson bankave që të zvogëlojnë apo eliminojnë procesimin manual duke shmangur shpenzimet për resurset e personelit, dhe duke rritur efikasitetin, si dhe përmirësuar përvojën bankare në përgjithësi për klientin. Po ashtu, klientëve u mundësohen alternativa të volitshme për pagesa të faturave pa para të gatshme përmes formave elektronike si e-banking, ATM etj.

## Konkluzion

Nga të dhënat e analizuara në këtë raport, konstatohet një rritje e vazhdueshme e përdorimit të skemës së pagesave Kos Giro, rritje e cila ka rezultuar nga efikasiteti dhe siguria që ofron kjo skemë, si dhe nga kompanitë pjesëmarrëse ekzistuese, ashtu edhe nga kompanitë e reja të cilat i janë bashkangjitur kësaj skeme të pagesave.

Përkundër trendit të lartë rritës, skema e pagesave Kos Giro edhe më tutje ofron mundësi të rritjes, si nga kompanitë pjesëmarrëse, ashtu edhe nga kompani të tjera potenciale të cilat mund t'i bashkëngjiten skemës. BQK-ja si rregullator, bankat komerciale si dhe kompanitë pjesëmarrëse në skemë, duhet të vazhdojnë angazhimin e tyre me qëllim të zgjerimit të mëtejshëm të kësaj skeme, duke përdorur shërbimin e-banking për procesim të transaksioneve Kos Giro.

Duke synuar gjithnjë rritjen e përdorimit të skemës Kos Giro, BQK-ja në vazhdimësi ka mbajtur takime me pjesëmarrësit aktualë dhe të tjerë potencialë, me qëllim të diskutimit të ideve apo problemeve me të cilat ata ballafaqohen, dhe si rezultat i këtyre takimeve kjo skemë është zhvilluar vazhdimisht dhe po ashtu është dizajnuar edhe versioni tjetër i faturës Kos Giro (v1.6) i cili redukton kostot e shtypjes së këtyre faturave.

Në vazhdim bankat komerciale dhe kompanitë pjesëmarrëse duhet t'iu kushtojnë kujdes promovimit të pagesave Kos Giro përmes mënyrave elektronike me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit dhe kjo njëkohësisht do të ndikonte te klientët në përdorimin e pagesave Kos Giro, pasi që do t'iu kursente kohë dhe njëkohësisht do të ndikonte në uljen e kostove të tyre.